



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.05.2019, ora 15:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Raport i Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” për veprimtarinë e kryer për periudhën nëntor 2018 – maj 2019.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Përmeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braho dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Damian Gjiknuri, Alban Zeneli, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar :

Artan Spahiu-Kryetar i Komisionit të Pavarur

Lindita Rusmali-anëtare

Petrit Plloçi- anëtar

Saimir Vishaj-anëtar

Irena Nino-anëtare

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Sot në rendin e ditës kemi raportimin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” për veprimtarinë e kryer nga ky komision për periudhën nëntor 2018 – maj 2019.

Para se t’ia jap fjalën kryetarit të komisionit dhe anëtarëve, dua të sjell në vëmendjen e kolegëve se ky komision është ngritur në përputhje me nenin 288 të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe në pikën 4 të këtij neni është e përcaktuar qartë se ky komision raporton pranë Komisionit të përhershëm përgjegjës për Çështjet Ligjore në Kuvend për ecurinë e zbatimit të ligjit sa herë është e nevojshme. E citova parashikimin ligjor të nenit 288 për t’u bërë me dije kolegëve se nuk do të kemi një raport dhe një projektrezolutë për Kuvendin në lidhje me veprimtarinë e këtij komisioni *ad hoc*, por raportin e këtij komisioni, pasi të ezaurojmë këtë seancë dëgjimore, do t’ia përcjellim Kryetarit të Kuvendit për ta bërë publik dhe për të njoftuar edhe seancën plenare për depozitimin e këtij raporti pranë Kryetarit të Kuvendit. Është shumë e rëndësishme që pas kësaj seance dëgjimore, raporti përmbledhës i komisionit të pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, siç janë bërë në dinamikë publike raportet periodike në faqen zyrtare të Kuvendit, të bëhet edhe raporti i sotëm.

Para se të prezantoj të ftuarit, dua t’i uroj mirëseardhjen në Komision të Ligjeve deputetes më të re të këtij komisioni, zonjës Ediola Braha. Zonja Braha, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Ediola Braha – Jam e nderuar që jam mes jush.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit!

Ju shkoftë mbarë dhe me krahë të lehtë!

Sot kemi të ftuar zotin Artan Spahiu, kryetar i Komisionit të Pavarur, zonjën Lindita Rusmali, anëtare dhe sekretare, zotin Petrit Plloçi, anëtar, por që për arsye objektive nuk është prezent, zotin Saimir Vishaj, anëtar, dhe zonjën Irena Nino, anëtare.

Zoti Spahiu, besoj se do të na e prezantoni ju raportin për veprimtarinë tuaj për periudhën nëntor 2018-maj 2019. Ju lutem, respektoni kohën në dispozicion prej 20 minutash!

E rëndësishme është që raportimin që keni përpiluar dhe gjetjet më kryesore të atij raporti për secilin nga institucionet që keni monitoruar të pasqyrohen siç duhet.

Artan Spahiu- Të nderuara zonja dhe zotërinj, anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Më lejoni, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Pavarur, të bëj një raportim të shkurtër për veprimtarinë e këtij komisioni për periudhën nëntor 2018-maj 2019.

Ashtu siç e tha edhe kryetari i komisionit, ky është një raportim, i cili bazohet në raportet periodike që ne kemi krijuar gjatë veprimtarisë së punës tonë.

Baza ligjore e krijimit të këtij komisioni është neni 288 i ligjit nr.115 dhe vendimi i Kuvendit nr.74 datë 31.06.2018. Zgjedhja e 5 anëtarëve të këtij komisioni është bërë në periudhën shtator-tetor të vitit 2018 dhe konstituimi i këtij komisioni është bërë me 5 nëntor të vitit 2018. Bazuar në këto dy akte, dy drejtimet kryesore të veprimtarisë së komisionit kanë qenë monitorimi i proceseve të përzgjedhjes së kandidatëve, të cilat janë zhvilluar pas konstituimit të Komisionit të Pavarur të Monitorimit, dhe koordinimi midis institucioneve dhe organeve që Kushtetuta dhe ligji u ngarkon detyra në lidhje me ngritjen e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Raportimet e këtij komisioni u janë drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore në Kuvend, institucioneve përkatëse të sistemit të drejtësisë, si dhe janë bërë publike në faqen zyrtare të Kuvendit, në rubrikën e dedikuar këtij komisioni. Ju kërkoj ndjesë për këtë *slide*, sepse është me shkrim të vogël, por këtu pasqyrohen të gjitha raportimet që ne kemi bërë në Kuvend dhe në Komisionin e Ligjeve, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare, ku gjithsej janë 10 raportime. Këto raportime dua t'i klasifikoj në: raportime, të cilat vijnë për shkak të monitorimit të procesit të zgjedhjes së anëtarëve të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, siç është raportimi në lidhje me krijimin e KPSED-së apo me procesin e votimit të anëtarëve gjyqtarë në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve për KLGJ-në, apo anëtarëve prokurorë në mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve për KLP-në. Një grup tjetër raportimi ka lidhje me veprimtarinë e organeve të ngritura të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, siç janë raportimet në lidhje me veprimtarinë e KPSED-së për emërimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe raportimet në lidhje me procesin e votimit, që është bërë për plotësimin e vendit vakant me anëtarë prokurorë në KLP. Gjithashtu, kemi edhe një grup tjetër raportimesh, që vijnë, jo kryesisht, me shkresë dhe kërkesë të institucioneve, bazuar në kërkesën e kryeinspektorese së ish-inspektoratit pranë KLD-së, ku kemi hartuar një raportim. Gjithashtu, bazuar në shkresë e Autoritetit të Verifikimit të Dosjeve kemi mbledhur, kemi shqyrtuar dhe kemi bërë një raportim tjetër. Pra, kategoritë e raportimeve janë pikërisht këto: raportime në lidhje me monitorimin drejtpërdrejt nga Komisioni i Pavarur në funksion të zbatimit të

kompetencës së tij të proceseve të zgjedhjes së kandidatëve; raportime në lidhje me veprimtarinë e këtyre organeve dhe raportime me kërkesë të institucioneve.

Kemi mbajtur korrespondencë me organet e institucionit që parashikon ligji nr.115 për periudhën para konstituimit dhe para ngritjes së organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, pra për periudhën nëntor-dhjetor, ku u kemi kërkuar Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe organeve të vetingut që të sjellin informacion lidhur me procesin se në çfarë momenti ishin faza e përzgjedhjes së kandidatëve për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Ndërkohë, pas krijimit të këtyre organeve, kemi mbajtur kontakte institucionale me to, ku përmendim marrëdhëniet me KLP-në dhe KLGJ-në. Këtu duhet evidentuar mungesa e komunikimit, më saktë një lloj ftohtësie nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ose KPSED-ja, e cila nuk pranoi kërkesën tonë për të marrë pjesë në mbledhjet e saj. Ata pretendojnë në zbatimin strikt të nenit 233, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 115, ku parashikohet në mënyrë shteruese se cilat janë organet që mund të marrin pjesë në mbledhjet e tyre, ndërkohë që në gjykimin e Komisionit të Pavarur, neni 288 i ligjit është një nen ombrellë, i cili mbulon të gjithë veprimtarinë monitoruese dhe i jep të drejtë Komisionit të Pavarur të Monitorimit të jetë pjesëtar dhe të monitorojë çdo lloj mbledhjeje, pavarësisht nëse ftohet ose jo. Gjithsesi, me anë të publikimeve që ata kanë bërë, ne e kemi monitoruar nga jashtë veprimtarinë e KPSED-së dhe gjykimin tonë për veprimtarinë e saj e kemi bërë mbi bazën e këtyre raportimeve. Ndërkohë, KLGJ-ja dhe KLP-ja na ftojnë në mbledhje sa herë që ata konstatojnë se janë mbledhje të rëndësishme, ku Komisioni i Pavarur duhet të marrë pjesë.

Pjesëmarrja drejtpërdrejt monitoruese e Komisionit të Pavarur është realizuar në mbledhjet e përgjithshme të prokurorëve dhe të gjyqtarëve, në procedurat e hedhjes së shortit për anëtarët e KPSED-së dhe në plotësimin e vakancës për KLP-në.

Gjithashtu, Komisioni i Pavarur ka marrë pjesë në disa mbledhje të KLGJ-së dhe KLP-së, si dhe në disa raste të tjera, siç është Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian dhe në takimet që ka zhvilluar EURALIUS.

Për sa u përket rezultateve të monitorimit, që në fillim të krijimit të këtij komisioni detyra e parë që ka bërë ka qenë urgjenca dhe nevoja që ekzistonte në momentin e krijimit, në nëntor të vitit 2018, ku ky komision ka gjykuar se duhet të fillonte me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, ose më saktë me Këshillin e Përkohshëm të Emërimit në Sistemin e Drejtësisë, me KPSED-në. Raporti që ne kemi hartuar shumë shpejt pasi jemi krijuar si komision ka qenë më 16 nëntor të vitit 2018, ku i kemi sugjeruar Kuvendit dhe Komisionit të Ligjeve që të trajtojmë me përparësi ngritjen e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë, duke gjykuar se deri në atë moment ishte përmendur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Në fakt, ne

ishim në kushtet ku duhet të ngrihej Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë, i cili është një organ që ka të njëjtat kompetenca, që funksionon në të njëjtën mënyrë dhe bën të njëjtat detyra, por që thjesht i referohet një dispozite tranzitore, nenit 284 të ligjit, i cili parashikon ngritjen e këtij organi në kushte kur KLGJ-ja dhe KLP-ja ende nuk ishin krijuar. Në gjykimin tonë, diskutimet dhe debati në lidhje me emrin KED apo KPSED nuk kishte pse ta bllokonte procesin, ndaj në këtë funksion ne kemi miratuar një raport dhe i kemi propozuar Kuvendit që të ngrihej Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë dhe nga Kuvendi është konsideruar, ku në datën 7 dhjetor është hedhur shorti për zgjedhjen e anëtarëve të Këshilli të Emërimeve në drejtësi, duke u quajtur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i Përkohshëm, i cili vazhdon të quhet i tillë.

Për sa u përket mbledhjeve që janë zhvilluar nga gjyqtarët dhe prokurorët për zgjedhjen e anëtarëve magjistratë në KLGJ dhe KLP, problematika e konstatuar ka qenë zgjedhja e komisionit të votimit përpara datës së zhvillimit të mbledhjeve, ndërkohë që dispozita e ligjit nr.115 parashikon që ky komision votimi duhet të bëhet në të njëjtën mbledhje me zgjedhjen e anëtarëve. Problem shqetësues ka qenë numri shumë i madh i fletëve të votimit të pavlefshme, të cilat i keni të listuara në mbledhjen e datës 11 dhjetor, ku 16,8% e votave kanë qenë të pavlefshme, në datën e mbledhjes 12 dhjetor kanë qenë 12,8% të pavlefshme dhe në mbledhjen e datës 11 prill në mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve për plotësimin e vakancës kishte 37,5% të votave të pavlefshme. Pra, një numër i madh votash të pavlefshme, që, në fakt, është shqetësues. Sipas gjykimit tonë, ky numër i madh pavlefshmërie votash nuk ka ardhur për shkak të keqinformimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por për shkak të mënyrës së votimit. Aty votohej me set fletësh votimi, me 2 ose 3 fletë votimi të kapura bashkë, ku më shqetësues ka qenë fakti se në fletën e votimit ku kandidohej vetëm me një emër kishte vetëm një mundësi zgjedhjeje. Pra, votuesit gjyqtar ose prokuror i krijohet mundësia ose të votojë pro ose ta konsiderojë votën e tij të pavlefshme. Në gjykimin tonë kjo cenon të drejtën për të zgjedhur. Pse vjen kjo?! Kjo vjen për shkak të mënyrës së ndërtimit të nenit 115 pika 2 “ç”, ku fleta e votimit nëse nuk është votuar për asnjë nga kandidatët konsiderohet e pavlefshme dhe lexohet si e tillë. Pra, nëse nuk votohet pro, konsiderohet e pavlefshme. Ne kemi propozuar që fleta e votimit të ketë dy mundësi zgjedhjeje për zgjedhësit, pro ose kundër. Në fakt, logjika e ligjit kërkon të ketë më shumë se një kandidaturë dhe në një proces ku zgjidhet të ketë më shumë se 1 kandidat dhe zgjedhësit të votojnë për njërin prej tyre. Në kushte kur ka vetëm një kandidat dhe lihet vetëm një mundësi zgjedhjeje, situata kthehet e tillë që... Edhe nga vetë trupa votuese pati reagime të shumta në lidhje me këtë mënyrë votimi, sepse është një lloj imponimi. Megjithatë, mënyra sesi është ndërtuar dispozita e ligjit, nuk të lejon që ta quash të pavlefshëm

kandidimin e vetëm një anëtar, sepse kjo do të sillte një situatë bllokuese dhe nuk parashikohet nga ligji që është e pavlefshme të kandidojë vetëm një anëtar. Do të ishte e udhës dhe do të ishte zgjidhja më e mirë e mundshme të bëhej një amendim i nenit 115 dhe në dispozitat respektive të parashikohej, qoftë për mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve dhe atë të gjyqtarëve, që, nëse kandidon vetëm një person, atëherë do të quhet i zgjedhur vetëm nëse merr më shumë se 50% të votave të numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve.

Për sa i përket ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë, Komisioni i Pavarur i Monitorimit e ka monitoruar këtë proces dhe ka dalë në konkluzionin se ka pasur problem lidhur me interpretimin në praktikë të shprehjes “Shkollës së Magjistraturës për magjistratët joanëtarë të Gjykatës Kushtetuese”, ku disa institucione e kanë kuptuar ndryshe dhe disa të tjerë e kanë kuptuar ndryshe. Ne kemi propozuar që të ketë një qëndrim unifikues lidhur me këtë përkufizim, në mënyrë që të përmbushet detyrimi kushtetues i parashikuar në nenin 149, germa “d”, paragrafët 2, 3 dhe 4.

Për sa i përket përfaqësimit në KPSED të të gjithë kategorive të gjyqtarëve dhe sa i përket drejtimit të këtij organi nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë, i zgjedhur nga shorti, organi drejtues i prokurorisë, KLP-ja, duhet ta konsiderojë detyrim të vetin të marrë masa që të ketë një përqasim të organit të prokurorisë me prokurorë që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës nga të gjitha nivelet që parashikon ligji. Organet që udhëheqin rivlerësimin kalimtar duhet ta konsiderojnë me përparësi procesin e verifikimit dhe kontrollit të anëtarëve aktualë të KPSED-së, gjë që ende nuk është bërë. Komisioni i Pavarur në raportimin e tij ka gjykuar dhe shprehur se gjyqtarët dhe prokurorët të zgjedhur në KPSED janë në ushtrim të plotë të funksioneve të tyre, pavarësisht se ende nuk ka një vendim të organeve të vetingut për ta, sepse procesi i vetingut dhe qenia anëtarë në KPSED janë dy procese që shkojnë paralel, por që nuk e pengojnë njëri-tjetrin. Nëse do të ketë një vendim përfundimtar të organeve të vetingut për t’i pezulluar apo përjashtuar nga funksione gjyqtar ose prokuror, atëherë atyre u krijohet një papajtueshmëri me funksionet dhe duhet të ikin edhe si anëtarë të KPSED-së.

Komisioni i Pavarur i ka rekomanduar vetë KPSED-së të miratojë sa më shpejt rregulloren e vlerësimit të kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe inspektorë të Lartë të Drejtësisë, e cila është bërë, të miratojë rregulla të detajuara, duke iu referuar procedurave analoge, të ndjekura më parë gjatë procesit të reformës në drejtësi për kandidatët magjistarë ose jomagjistarë. Kemi insistuar dhe kemi vënë theksin pikërisht tek fakti që KPSED-ja, apo KED-ja e përkohshme nuk mund të jetë një organ i pavarur në këtë sistem, por duhet të jetë pjesë e sistemit. Referencat, interpretimet dhe procedurat, që janë përdorur nga organet e mëparshme qoftë për magjistratët, qoftë për jomagjistratët, duhet të referohen dhe

duhet të zbatohen për analogji edhe nga vetë KPSED-ja. Kemi kërkuar shmangien e konfliktit të interesit të disa anëtarëve të KPSED-së, të cilët kandidojnë për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese apo janë kandidatë për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, dhe kjo është bërë në dijeninë tonë. Janë informacione, të cilat ne i kemi marrë nga faqja zyrtare, sepse nuk jemi pjesë e mbledhjeve të KPSED-së.

Kemi marrë kërkesën e ish-kryeinspektorese së Inspektoratit pranë ish-KLD-së në lidhje me ecurinë e mëtejshme të veprimtarisë inspektuese të këtyre inspektorëve për periudhën midis ngritjes së KLGJ-së, pra mbarimit të mandatit të ish-KLD-së, dhe emërimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe ne kemi rekomanduar që trupa e inspektorëve të atashohet si pjesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe KLGJ-ja të miratojë rregulla dhe procedura të posaçme për administrimin e akteve dhe raporteve të këtyre inspektorëve, veçanërisht në përmbushje të funksioneve, që atyre u kanë mbetur dhe që parashikohen nga dispozitat transitore të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve” dhe kanë të bëjnë pikërisht me vlerësimin e punë së gjyqtarëve, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të tyre, për aq sa parashikon ligji, dhe angazhimi në procesin e shqyrtimit të praktikave të lidhura me masën disiplinore.

Kemi monitoruar veprimtarinë e KPSED-së, në funksion të zgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe problematikat, që ne kemi konstatuar, kanë qenë të lidhura pikërisht me faktin e miratimit të rregulloreve, qoftë për procedurat e verifikimit të kushteve, qoftë për metodologjinë e pikëzimit të kriterëve, sepse verifikohen kushtet ligjore dhe vlerësohen kriteret. Të dyja këto rregullore janë miratuar pas administrimit të kandidaturave. Në gjykimin tonë, kandidaturat duhej të vinin pas miratimit të rregulloreve dhe jo anasjelltas. Pikërisht për këtë arsye i kemi sugjeruar KPSED-së të parandalojë çdo formulim, që mund të paragjykohej nga publiku, i kemi kërkuar të jetë koherente në interpretimet e dhëna më parë nga organe të tjera, që kanë pasur angazhime në kuadër të sistemit të drejtësisë. Të dyja rregulloret, që janë shkruar nga KPSED-ja qoftë për procedurën e verifikimit të kriterëve, qoftë për atë të vlerësimit dhe pikëzimit janë shkruar në kontekstin e funksionimit të procesit të vetingut dhe procesi i vetingut pezullon, në njëfarë mënyre, vetë procesin e verifikimit dhe pikëzimit të proceseve të kriterëve, gjë që, në mendimin tonë, duhej të ishte gjykuar ndryshe.

Është e pazbatueshme kompetenca, që i është lënë relatorit për të bërë verifikimet shitesë deri në vendimin e tij për angazhimin ose jo të ekspertëve. Relatori, në zbatim të detyrimit ligjor, kërkon kontrollin e pasurisë, nuk bën kontrollin e pasurisë.

Gjithashtu, kemi kërkuar që KED-ja në asnjë rast nuk mund të marrë, as për analogji, kompetenca të ngjashme me ato të organeve të vetingut. Në qoftë se KED-ja duhet të verifikojë

apo ka nevojë të verifikojë, thjesht duhet t'u adresohet institucioneve shtetërore, si ILDKP-së apo Prokurorit të Përgjithshme për të marrë verifikime shtesë, por nuk mund t'i bëjë vetë.

Gjithashtu, kemi vlerësuar rregulloren e KPSED-së për kriteret dhe procedurën e pikëzimit dhe konstatojmë se, në qoftë se neni 240, pika 6 kërkonte të rregullore të ishte shteruese, pra të ishte përfundimtare dhe të përcaktonte metodologjinë përfundimtare të pikëzimit, në kushtet kur lista kandidatëve kishte ardhur (në fakt, nuk është bërë), rregullorja në vetvete lë mundësi lë hapësira për KPSED-në për të miratuar rregulla të tjera. Një dispozitë e rregullores thotë: “KPSED-ja do të miratojë dhe do të bëjë publike metodologji të tjera, në funksion të pikëzimit të kriterëve”. Kjo nuk është e drejtë. Kjo rregullore duhej të ishte shteruese tashmë, madje, në gjykimin tonë, para ardhjes së kandidaturave, ndërkohë ende nuk ka përfunduar dhe nuk ka një afat kohor se kur do të përfundojë. Duket sikur detajohen rregulla të mëtejshme pas mbledhjes së kandidaturave dhe kjo nuk është e drejtë për procesin.

Rregullorja ka një parashikim që, në fakt, mbart parashikimet e neneve 7/b dhe 7/c të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ku parashikohet se, kur krijohet më shumë se një vakancë nga i njëjti organ emërtese, përgatiten dy lista, pastaj krijohet një lloj paqartësie se nga do të emërohen kandidatët.

Gjithashtu, për komisionin ka qenë i paqartë, dhe i është bërë me dije KED-së, fakti që i është dhënë në mënyrë të pashpjegueshme një peshë shumë e madhe specifike një kriteri që është ambig: “rezultatet e vlerësimit profesional dhe etikës së kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën”, ose “rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës”. Kësaj i është dhënë një peshë e madhe, gjë që mund të krijojë mundësi ndoshta për një lloj keqpërdorimi ose keqkuptimi në publik dhe kjo do të ishte e dëmshme.

Kemi marrë në shqyrtim rastet e trajtuara nga komisioni në lidhje me mbarimin e parakohshëm të mandatit të anëtarëve të KLP-së, deklarin e mbarimit për një anëtar dhe krijimin e një shkaku pazgjidhshmërie për një anëtar tjetër. I kemi kërkuar KLP-së në dy raporte ta marrë në shqyrtim situatën dhe të zbatojë dispozitat e Kushtetutës dhe të ligjit. Në të dytin i kemi kërkuar të na bënte me dije se çfarë ka bërë në lidhje me këtë rast, ndërkohë nuk na është vënë në dispozicion asnjë lloj informacioni se çfarë është bërë. Prokurores së Përgjithshme i kemi kërkuar që të fillojë urgjentisht procedura për të plotësuar vakancën. Në fakt, kjo është bërë, pra më 11 prill është bërë mbledhja e përgjithshme e prokurorëve dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë është plotësuar me një prokuror.

Këto janë ato që ne kemi bërë deri tani. Fokusi në të ardhmen do të jetë monitorimi i veprimtarisë së KED-së, sepse ka mbetur ende pa u zgjedhur, sikurse e dimë të gjithë, edhe një organ tjetër i qeverisjes së drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Monitorimi i këtij procesi

do të jetë në fokus. Gjithashtu, edhe monitorimi i veprimtarisë së KLP-së dhe KLGJ-së për sa u përket momenteve më të rëndësishme që ato kanë, si: miratimi i listës dhe i renditjes së kandidaturave për Prokuror të Përgjithshëm, emërimi i prokurorit të posaçëm, monitorimi i veprimtarisë së KLGJ-së në lidhje me procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe emërimet apo ngritjet në detyrë të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, pavarësisht se këto nuk janë në fokusin e punës së komisionit, po t'i referohemi nenit 288. Në fakt, për nenin 288, që në momentin kur ne u krijuam kemi pasur debate edhe midis nesh për sa i përket gjerësisë apo ngushtësisë, me të cilën do ta interpretonim atë, por vendimi nr. 74 i Kuvendit na i ka kufizuar pak, sepse na jep autoritet deri në momentin e ngritjes dhe fillimit të funksionit të këtyre organeve. Gjithsesi, momentet më të rëndësishme të punës së KLGJ-së dhe KLP-së ne do t'i kemi në fokus të monitorimit tonë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Spahiu, për këtë raportim shterues dhe konciz për këtë periudhë të funksionimit të komisionit që ju drejtoni! Nuk e di nëse kolegët kanë pyetje apo diskutime.

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti kryetar i Komisionit të Pavarur!

Unë i kam lexuar raportet e komisionit tuaj herë pas here dhe dua t'ju përgëzoj për punën profesionale dhe koncize që keni pasur në vijimësi. Në fakt, këtë mekanizëm e ka parashikuar ligjvënësi, kur ka krijuar të gjithë arkitekturën e sistemit të drejtësisë që, ndryshe nga monitorimi klasik që i bën Kuvendi ekzekutimit të ligjeve, zbatimit të ligjeve, në rastin e ligjeve të reformës në drejtësi është menduar që, derisa të ngrihen organet e reja të drejtësisë, të jetë ky Komision i Pavarur. Më vjen mirë t'ju dëgjoj sot dhe t'ju them përballë se puna që keni bërë deri tani, është e lavdërueshme!

Pyetja ime ka të bëjë me faktin e konstatimeve që keni bërë në kuadër të procesit të vlerësimit që po u bëhet kandidatëve, të cilët kanë shprehur interesin, ose garojnë për vendet në Gjykatën Kushtetuese dhe në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë. Ju e thatë edhe vetë që neni 288 i ligjit “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë” dhe vetë vendimi Kuvendit ju kanë kufizuar. Në fakt, nuk jua kanë kufizuar detyrën. Të dyja këto nene ju kanë dhënë mundësi që të monitoroni çdo hap, deri në ngritjen e organeve të reja të drejtësisë. Pra, në qoftë se ju sot monitoroni, për shembull, KED-në ju keni të drejtë të monitoroni punën e KED-së për sa i takon ngritjes së Inspektoratit apo plotësimit të vakancave në Gjykatën Kushtetuese, të cilat janë elemente që vijnë si pasojë e zbatimit të reformës në drejtësi. Kështu që jeni brenda

kompetencave tuaja dhe nuk keni ndonjë kufizim. Kështu që nuk e di se ku është shqetësimi juaj në këtë pikë! Më shqetëson ta di, sepse, kur thoni “shikojmë kufizim”, do të thotë se nuk jeni të lirshëm të kryeni kompetencat dhe detyrat tuaja? Keni nevojë për plotësim të kuadrit ligjor, që mund t’ju bëjë ju më të aftë për ta kryer detyrën, brenda tagrit dhe kompetencës, sepse ne për këtë punë ju dëgjojmë ju? Duke qenë se ju kryeni aktivitetin monitorues, ne jemi këtu që rekomandimet tuaja dhe shqetësimet t’i marrim në konsideratë dhe të bëjmë detyrën tonë.

Pyetja e dytë ka të bëjë me një shqetësim që ngrihet: unë si ligjvënese dhe si pjesë e politikës, pavarësisht se jam juriste, kam një merak shumë të madh. Interesi ynë është që organet e reja të qeverisjes së drejtësisë të ngrihen një orë e më parë dhe mendoj se kaq na takon neve. Në momentin kur ngrihen ato, edhe politika është më e qetë, është më e distancuar, nuk atakohet më nga qytetarët apo nga aktorët politikë se po ndërhyjnë në drejtësi.

E lexova me shqetësim komentin që bëtë ju, pra që KED-ja është duke kryer vlerësimin, duke i kryer vetë veprime apo, duke përdorur raportet e organeve ligjzbatuese, të cilat kryejnë vlerësim dhe mbi ato KED-ja bën vlerësimin e saj. Pra, këtë dua që ta shpjegoni pak më qartë, sepse ne i nuk njohim as rregulloret e KED-së dhe as mënyrën se si punon KED-ja. Jeni ju ata që, nuk e di nëse e keni monitoruar apo e keni vlerësuar, duhet të na e shpjegoni. Sa ndikon kjo, nëse ju keni arritur në një konstatim, në faktin e vonësës për ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë?

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Urdhëroni, zoti Spahiu!

Artan Spahiu – Faleminderit për pyetjet!

Për sa i përket pyetjes së parë në lidhje me qartësinë e nenit 288, dua ta sqarojmë, se shpesh ngatërrohem edhe kur jemi pyetur nga mediet, domethënë konsiderohemi si komisioni që monitoron reformën. Në fakt, ne jemi komisioni që monitoron një pjesë të rëndësishme të reformës, por jo të gjithë reformën, sepse ka shumë komponentë. Ne monitorojmë ngritjen e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, gjithsesi, duke qenë se monitorojmë ndjekjen dhe zbatimin e ligjit, siç është neni 288, ligji parashikon edhe mënyrën se si funksionojnë këto organe. Kështu që me këtë kemi kuptuar se mund të monitorojmë veprimtarinë e KLGJ-së dhe KLP-së për ato momente kur ato do të miratojnë vendime të rëndësishme, siç është rasti i Prokurorit të Përgjithshëm apo i ngritjes së Gjykatës së Posaçme, SPAK-ut e të tjera. Për sa i përket KED-së dhe veprimtarisë së saj për miratimin e listës, që do t’i propozojë Kuvendit për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, është detyra jona e drejtpërdrejtë ta monitorojmë, por ILD-ja absolutisht është organ i qeverisjes së drejtësisë. Këtu nuk bëhet fjalë fare për ILD-në. Prandaj thashë “në qoftë se KLGJ-ja dhe KLP-ja na ftojnë në mbledhje, sa herë që ato gjykojnë se janë

momente të rëndësishme...” Nga KED-ja nuk kemi asnjë lloj kontakti, ndërkohë që ne aty duhej të kishim kontakt, duhej të na e ofronin, ose të na kërkonin ndoshta jo për mendim, por të paktën për një lloj monitorimi, sepse e kanë detyrim ligjor. Ata bazohen te neni 233, i cili përcakton se kush merr pjesë te mbledhja e KED-së. Ndërkohë, neni 288 thotë se ne e monitorojmë procesin e ngritjes, pra ne mund të shkojmë pa ftesë dhe nuk kemi nevojë për ftesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

KED-ja nuk ka filluar ende t’i vlerësojë. Është në momentin e miratimit të rregulloreve. Ne kemi menduar, domethënë do ta diskutojmë me komisionin, se tani unë po flas para kohe, edhe për një lloj interpelance që mund t’i bëjmë kryetarit të KED-së, pra një dëgjese, sepse na e parashikon rregullorja për ta ftuar. Pavarësisht se ato janë organe kushtetuese, gjithsesi, ne do t’ua bëjmë një ftesë për të ardhur dhe për të na sqaruar për këto momente dhe për të ngritur këto probleme që identifikojmë nga rregullorja se mund të jenë problematike. Ne nuk e dimë sa problematike janë, sepse kemi gjykuar thjesht nga rregullorja, madje që është botuar në Fletoren Zyrtare, sepse as nuk na e kanë sjellë rregulloren. Ne thjesht e marrim, si çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë, rregulloren, kemi analizuar dhe kemi parë se aty mund të krijohen probleme për ambiguitet, për dykuptimësi apo për një interpretim të tejkaluar të autoritetit të KED-së. KED-ja, absolutisht, nuk mund të jetë organ vetingu. KED-ja duhet t’i kërkojë informacion, kjo është taksative, në gjykimin tonë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Spahiu!

Urdhëroni, zoti Hyseni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Spahiu – Vetëm nga rregullorja ne jemi nisur dhe kemi thënë se ka mundësi për t’u bërë kjo, sepse ata ende nuk kanë filluar të veprojnë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju falënderoj për parashitjet e raportit!

Në vijim të koleges Bushka, edhe unë dua t’ju falënderoj për të gjithë punën e mirë që keni bërë në këtë proces, që, në fakt, është jo vetëm i rëndësishëm, por edhe delikat, në të cilin parlamenti ka pak rol dhe atë rol që ka, është menduar ta ndjekë nëpërmjet jush. Nga raportimet në vijimësi, por edhe nga ky raport, unë mendoj se ju e keni justifikuar plotësisht besimin e këtij komisioni.

Unë dua të jem pak më konkret, dhe, para se të bëj një pyetje, gjej rastin të bëj një vërejtje, nëse më lejohet. Ky komision duhej të ishte rakorduar me disa institucione, të cilat u përmenden këtu, sepse nuk më vjen mirë që këtu ngrihen problematika për Prokurorinë e Përgjithshme, ndërkohë që rekomandimet janë votuar dhe duhej të ishin raportuar këtu nga Prokurori i Përgjithshëm. Mos ndoshta duhet të presim vitin e ardhshëm? Në radhë të parë i tërheq vëmendje Shërbimit të Monitorimeve të Kuvendit, sepse duhej të ndërtonte një grafik më të përshtatshëm për raportimin e institucioneve dhe t'i ndërlidhte. Këta që monitorojnë, duhet të raportojnë në fund, sepse të parat raportojnë institucionet. Më pas, sipas problematikave që ky komision u ka adresuar këtyre institucioneve, ne mund t'u kërkojmë llogari. Marr shkas për të referuar një situatë, të cilin në raport e shikoj me *bold*, që ka lidhje me procedurën e ndjekur nga mbledhja e përgjithshme e prokurorëve. Unë dua të di nga ju nëse rekomandimi që ju cituat këtu, por edhe disa të tjera që janë në tabelën e rekomandimeve dhe që dalin të pazbatuara, kanë qenë para mbledhjes?

Këtë e them sepse kjo çështje ka qenë sensibil për opinionin publik, ku, me çfarë kemi parë në medie, drejtuesi i mbledhjes ka thënë se ju ua keni dërguar me vonesë propozimet disa prokurorëve. Nëse ju e keni bërë këtë gjë, atëherë situata për mua është serioze dhe duhet ta lexojmë ne, si Komision i Ligjeve dhe si Kuvend. Prandaj, ju lutem, kërkoj nga ju një shpjegim më të plotë se kur ia keni bërë rekomandimin Prokurorit të Përgjithshëm apo mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve? Më pas kam të drejtën time për të diskutuar.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Spahiu.

Artan Spahiu – Në mos gaboj, ju i referoheni propozimit tonë për rastin e votimit me një kandidat të vetëm, apo jo? Fleta e votimit ka dy mundësi për zgjedhësin. Propozimi ynë është bërë me raportin e datës 14 dhjetor, dy ditë pas mbledhjes së parë të prokurorëve. Në mbledhjen e dytë të prokurorëve, që është bërë për plotësimin e vakancës, në datën 11 prill, ky propozim nuk është marrë në konsideratë. Ne e kemi ritheksuar dhe ka qenë pikërisht ky propozim, që shkaktoi një shqetësim nga ana e disa prokurorëve, me të cilët patëm një debat, edhe me Prokuroren e Përgjithshme. Ata donin të bënin ndryshimin e rregullores në atë moment, por ky ndryshim ishte i pamundur. Në qoftë se ata do ta kishin konsideruar këtë pikë, kjo gjë do të ishte zgjidhur në një diskutim tjetër. Mund të na kishin thirrur edhe ne për t'ua sqaruar më mirë.

Raportimi ynë është bërë në datën 14 dhjetor dhe i është përcjellë Prokurores së Përgjithshme. Nga data 14 dhjetor deri në datën 11 prill nuk ka pasur asnjë reflektim në lidhje me propozimin tonë.

Lindita Rusmali – Kam edhe diçka të fundit.

Në mbledhjen e parë ne konstatuam se mund të ishte problem për shkak të analizës që u bëmë rregullave. Në mbledhjen e dytë ky problem u vërtetua. Pra, analiza që ne bëmë, duke i paraprirë kështu mbledhjes së dytë, nuk u konsiderua edhe në mbledhjen e dytë.

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Rusmali!

Edhe një herë për ta qartësuar këtë, që të mos bini ndesh me raportimin tuaj. Ju e konsideroni këtë një problem ligjor apo problem ne rregullor? Ju duhet të jeni të qartë në këtë pikë: a është problem i ligjit apo i akteve nënligjore?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, nuk ju kërkova zgjidhjen e problemit! Ju nuk jeni këtu për ta zgjidhur këtë problem, por jeni për të raportuar për monitorimin që keni bërë. Pra, kjo çështje është një problem ligjor apo i akteve nënligjore? Pastaj se çfarë rekomandimi keni bërë, mund të na e thoni.

Artan Spahiu – Unë mendoj se në raport është sqaruar shumë qartë.

Mënyra e votimit, sipas nenit 115, ka një logjikë të tillë që do të ishte mirë që kandidaturat të ishin më shumë se një, por edhe fakti që kandidon vetëm një person nuk mund ta bllokojë procesin. Procesi është transparent dhe e lejon mundësinë e kandidimit të një personi të vetëm. Prokurorët kanë pasur gjithë kohën e mundshme që të kandidonin dhe në këtë aspekt jemi shprehur shumë qartë. Nuk mund t'i mohohet e drejta për t'u zgjedhur qoftë edhe një kandidati të vetëm, sepse pjesa tjetër mund ta bllokojë. Kjo çështje mund të kthehet në një situatë bllokuese dhe është më keq. Gjithsesi, edhe pse nuk do të ketë relevancë në mungesë të një ndryshimi ligjor, ne gjykojmë se fleta e votimit duhet të ketë dy mundësi zgjedhjeje, thjesht dhe vetëm për të parë se sa mbështetje ka kandidati. Ashtu siç është ndërtuar neni 115, votat kundër nuk kanë vlerë nëse kandidon një anëtar i vetëm.

Ulsi Manja – Ju sugjeroni që neni 115 ka probleme dhe duhet ndërhyrë?

Artan Spahiu – Kjo do të ishte zgjidhja ideale.

Ulsi Manja - Në rregull! Ky është propozimi juaj.

Pra, neni 115 ka probleme dhe duhet ndryshuar.

A ka pyetje të tjera nga kolegët, në mënyrë që të kalojmë në fazën e diskutimeve?

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Unë, personalisht, nuk jam shumë i qartë, prandaj do të doja një sqarim në lidhje me plotësimin e vendit vakant për KLP-në, për zonjën Antoneta Sefdari. Pra, kush e ka ndjekur këtë proces deri në emërimin e saj?

Artan Spahiu – Mbarimi i mandatit është deklaruar sipas ligjit, me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Më pas në raportimin tonë ne i kemi kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm t'i hapte procedurat sa më shpejt për ta plotësuar vendin me një kandidaturë, që do të votohej nga radhët e prokurorëve. Në datën 11 prill është bërë mbledhja dhe ka pasur një afat kandidimi, ku ka kandiduar një prokuror i vetëm dhe me një kandidaturë është bërë procesi i zgjedhjes, ka marrë votat dhe sot është anëtare i KLP-së.

Ulsi Manja – Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Mua më intereson fakti që ju, si strukturë e monitoroni procesin, gjithashtu edhe personin që garon, apo jo?

Artan Spahiu – Ligji e parashikon shumë qartë se cili ka autoritetin për të verifikuar kushtet. Ne thjesht monitorojmë dhe, në qoftë se konstatojmë probleme, i raportojmë. Autoriteti ynë shkon deri te Komisioni i Ligjeve.

Adriatik Alimadhi - Pra, ju vetëm konstatoni.

Artan Spahiu – Po, ne vetëm bëjmë konstatimin.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në diskutime.

Fjalën e ka kërkuar zoti Hyseni.

Alket Hyseni- Faleminderit, zoti kryetar!

Duke vijuar logjikën e diskutimit që nisa, ky komision për mua ka shumë ekspertë, të cilët e njohin fushën dhe janë zëri, veshi dhe syri i Komisionit të Ligjeve dhe i parlamentit të Republikës së Shqipërisë në monitorimin, pa pasur asnjë ndikim, të reformës në drejtësi.

Cili ishte qëllimi që ne e kemi ngritur këtë komision? Ligjvënësit kanë parashikuar një hallkë të ndërmjetme për të monitoruar një reformë të madhe, e cila ndodh për herë parë në historinë e shtetit shqiptar me këtë cilësi, por edhe me këtë formë procedurale. Disa kolegë ishin skeptikë përse duhej kjo reformë, çfarë do të bënte, por ne dolëm me një vendim, ku detajua kompetencat që ligji i njeh komisionit dhe këto kompetenca janë të qarta, të cilave u jeni referuar dhe keni ushtruar veprimtarinë tuaj. Ajo që mendoj se nuk është kuptuar nga institucionet janë rekomandimet tuaja, për të cilat ju do të jepni llogari në Kuvend në një moment të caktuar. Mund të mos i zbatoni se nuk janë detyrime ligjore, por llogari do të jepni një ditë. Nga kjo marr shkas për të thënë se ne, pavarësisht pushteteve, funksioni “*checks and*

balances” është i padiskutuar. Edhe ne, si ligjvënës, kontrollohemi dhe kalojmë në disa filtra, ku, përveçse politikisht, kalojmë edhe filtra të tjerë, ndaj edhe këto institucione nuk mund të jenë kaq të papërgjegjshme. E them këtë, sepse kjo çështje ka qenë sensibil në medie. Votimi, që është bërë në këto institucione me një alternativë të vetme, është votim triskash, nuk është votim demokratik. A mund të bëhen zgjedhjet vetëm me një kandidat?! Patjetër, se procesi është i pandalshëm, ndaj edhe një prokuror i vetëm, edhe një gjyqtar i vetëm mund të aplikojë dhe duhet të vendoset nga mbledhja e përgjithshme, por procedura e votimit, në shekullin e XXI, nuk ka nevojë më për t’u lexuar, nuk ka nevojë më për të shpikur rrota. Procedura e votimit është një dhe vetme me alternativë “pro” ose “kundër”. Nuk ka interpretim të dytë për këtë çështje. Kush bën një interpretim të dytë, ose ka qëllim jo të mirë, ose nuk është i denjë, sepse nuk e njeh ligjin.

Unë mendoj se pjesa e dytë nuk mund të vlejë, sepse kemi të bëjmë me juristë, të cilët janë juristë karriere, kurse për pjesën e parë mendoj se këtë do ta tregojë koha.

Unë ftoj komisionin që të vazhdojë punën dhe këto rekomandime duhet t’i nxjerrë të parat në listë. Kjo është e gjithë puna juaj, ndaj problemet që keni nxjerrë, rekomandimet që keni bërë, do të nxjerrin se cili nuk u është përgjigjur këtyre rekomandimeve. Këto duhet t’i kemi parasysh edhe në rezolutat që ne nxjerrim ndaj kujtdo institucioni. Nëse nuk e kanë dëgjuar zërin e këtij komisioni, që është zëri ynë, ne duhet të bëjmë një rezolutë të fortë si detyrë për të mos e bërë më, por edhe si shkelje e detyrimeve ligjore.

Unë dua t’ju falënderoj për punën dhe dua t’ju inkurajoj që të tregoheni më të fortë, sepse kjo është nëna e të gjitha reformave. Te kjo reformë i kanë sytë 99% e shqiptarëve dhe ju jeni zëri, syri dhe veshi ynë në kontaktin e drejtpërdrejtë që bëhet atje për këtë reformë.

Ju lutem, bëjeni presionin maksimal, sipas ligjit, që ajo reformë të ecë sa më shpejt, por të jetë edhe me cilësi, në mënyrë që të gjitha organet që janë ngritur, por edhe ato që do të ngrihen, të jenë eficiente në zbatimin e detyrimeve të tyre kushtetuese edhe ligjore.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zoti Fino.

Bashkim Fino - Faleminderit, zoti kryetar!

Marr shkas nga parafolësi, sepse më pëlqeu diskutimi i tij.

Kjo është mbledhja e parë dhe unë u uroj suksese edhe atyre që mungojnë! Pavarësisht se ju keni përgatitur gati 10 materiale, unë pata mundësi të lexoja vetëm këtë. Pse e kemi krijuar ne Komisionin e Pavarur të Monitorimit? Nuk e kemi krijuar kot. Ne në Kuvend kemi një Drejtorin të Monitorimeve dhe këtu kemi gjithë këtë staf , i cili mund ta bënte shumë mirë

monitorimin dhe zbatimin e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin drejtësisë”.

Ne e kemi krijuar Komisionin e Pavarur të Monitorimit që të jetë i pavarur, me ekspertë të vlerësuar të fushës, siç jeni ju, për të ndjekur ecurinë e zbatimit të ligjit “Për organet e qeverisjes në sistemin drejtësisë”. Një komision i tillë monitorimi është i fortë, në qoftë se Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi janë të fortë. Një komision i tillë do të mbetet thjesht për të bërë disa letra dhe për të bërë disa raporte, për t’u shënuar në procesverbale mbledhjen e radhës, për sa kohë që ne nuk veprojmë. Pra, ajo që dua të them është se, sa më të fortë të jeni ju në monitorimin e ligjit “Për organet e qeverisjes në sistemin drejtësisë”, aq më të fortë do të jemi edhe në vendimmarrjen tonë, të cilat mund të kenë probleme, por që do t’i rregullojmë.

Lidhur me këtë problematikë që sapo ju thatë tani, më lejoni të them se ata duhet të kenë “frikë”, sepse natyrisht janë zgjedhur për të qenë të pavarur nga monitorimi që ju bëni. Kjo do të thotë se monitorimi juaj, informacioni juaj dhe vendimmarrja jonë, si Komision Ligjeve, janë shumë domethënëse, sepse nuk ka të bëjë thjesht me një rezolutë, siç u shpreh edhe kolegu im.

Për të gjitha organet kushtetuese, që vijnë dhe raportojnë këtu, ne bëjmë një rezolutë dhe e krahasojmë me rezolutat e vitit të kaluar. Më pas dalim në konkluzione dhe themi që këtë e ka bërë, këtë nuk e ka bërë e të tjera. A e dini se kur do ta kemi forcën ne si Komision i Ligjeve dhe si Kuvend? Kur t’i themi një institucioni të caktuar lidhur me rekomandimet e rezolutës së këtij viti, në raport me vitin e kaluar se nuk është bërë asgjë dhe të marrim iniciativën për ta shkarkuar drejtuesin kryesor të atij institucioni. Ata nuk vijnë kot të raportojnë këtu, sepse, në qoftë se çështja është thjesht për të bërë një raportim sa për t’u dukur, atëherë ne kot që jemi këtu dhe kot që e paskemi ngritur këtë njësi të monitorimit.

Prandaj, unë dua t’u tërheq vëmendjen kolegëve, duke ju dhënë forcë edhe juve, nëpërmjet këtij diskutimi, që ju duhet ta bëni shumë më energjike punën për të na dhënë neve mundësinë që të ndikojmë shumë fort te këto institucione, në mënyrë që vërtet ligji “Për organet e qeverisjes në sistemin drejtësisë” të realizohet me sukses, gjë të cilën e kërkojnë të gjithë shqiptarët. Më pas, lidhur me ato që ju do të na informoni, ne, si komision, por edhe si Kuvend, do të kemi të drejtën e vendimmarrjes për këto institucione.

Së fundi, për sa kohë që ne si Kuvend nuk kemi bërë model asnjë institucion, kushdo qoftë institucioni i krijuar me Kushtetutë apo i krijuar rishtazi nga Kuvendi, dhe t’i themi titullarit që nuk e ka bërë siç duhet punën e vitit e kaluar dhe të marrim një vendim për ta shkarkuar, atëherë kam përshtypjen se komisioni juaj do të mbetet thjesht një format. Megjithatë ju nuk jeni pjesë e Kuvendit të Shqipërisë, mendoj se roli, fuqia dhe vendimmarrja

juaj rekomanduese për ne duhet të jetë i lartë, në mënyrë që më pas të marrim një vendim përkatës të formës së prerë.

Unë kështu do ta konceptoja mbledhjen e radhës dhe kështu dua ta konceptoj çdo informacion që ju duhet të na jepni, në mënyrë që ne të ndërhyjmë me vendimmarrje, qoftë edhe ndonjë ndryshim të një neni të caktuar të ligjit, në qoftë se ka mundësi të ndryshohet, në mënyrë që të mos bëhet pengesë. Në asnjë mënyrë nuk mund të dëgjoj dhe të konceptoj se institucionet tona, të krijuara me ligj nga ne, nuk e ftojnë Komisionin e Monitorimit. Nuk ka këtu një nen apo një rregullore që nuk e lejon këtë gjë. Ju vetë thatë se e keni për detyrë që të shkoni në çdo institucion, edhe pa marrë fare ftesë, për t'i monitoruar. Në qoftë se ata ju drejtojnë gishtin nga dera, ju menjëherë, brenda 24 orëve duhet të na thoni ne, që edhe ne t'ia tregojmë derën atij tjetrit, kushdo qoftë ai. Por ti dhe i gjithë komisioni jeni për këtë punë. Këtu e kam thelbin e diskutimit që po bëj, prandaj ky komision duhet të marrë fuqi të plotë dhe ta tregojë veten për të na dhënë ne mundësinë. Pastaj sa jemi të zotë, ne si komision dhe si parlament të bëjmë diçka, kjo është një çështje tjetër.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

A ka diskutime të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ju lutem, sepse jemi në fazën e diskutimeve.

Nuk ka diskutime.

Më lejoni t'ju informoj në lidhje me disa nga problematikat që ngritën me të drejtë zoti Fino, zoti Hyseni dhe zonja Bushka.

E para, zoti Hyseni, unë jam korrekt në atë që më autorizon ligji. Raportimi i këtij komisioni të pavarur bëhet përpara raportimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në këtë komision. Nëse i qëndrojmë strikt asaj që thotë neni 288, këto janë organe *ad-hoc* që monitorojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, por nuk ka lidhje me qeverisjen e sistemit të drejtësisë Prokurori i Përgjithshëm. Dy organet që ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji me qeverisjen janë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Raportimin e këtij institucioni e kam thirrur ashtu siç më autorizon ligji, përpara raportimit të Këshilli të Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë këtu, si dy struktura që monitorohen drejtpërsëdrejti në aktivitetin e tyre nga ky komision i pavarur. Unë jam shumë korrekt në atë që më autorizon rregullorja e Kuvendit por edhe ligji.

Megjithatë, kjo ka pak rëndësi, sepse nuk meriton të ndalojmë.

Dua t'ju falënderoj për cilësinë e punës dhe të raporteve që prodhoni, por jo për publicitetin e punës që bëni.

Jam dakord me zotin Fino që neve si Kuvend dhe si Komision Ligjesh na takon ta rrisim autoritetin tuaj, por një organ *ad-hoc*, siç jeni ju, e rrit autoritetin nëpërmjet cilësisë së punës, komunikimit dhe transparencës që i bën punës.

Për pjesën e parë ju meritoni të gjithë vlerësimet e komisionit, sepse çdo raport që keni prodhuar, me aq sa më lejon ligji, ua kam nisur deputetëve nëpërmjet postës elektronike, i kam bërë publike në faqen e Kuvendit dhe hapi i tretë është edhe kjo seancë dëgjimore që po bëjmë sot, por keni bërë shumë pak në pjesën e dytë, pra që të rriteni si strukturë. Ju nuk jeni anonim, por jeni një strukturë e Kuvendit dhe e ngritur nga Kuvendi. Për të ulur çdo paragjykim që ka në drejtim të cilësisë së anëtarëve të këtij komisioni po jua them unë: ju ndoshta nuk jeni persona publike, por ju garantoj se raportet që i keni hartuar kanë një cilësi të lartë dhe janë shumë më cilësore se raportet që mund të bëjnë shumë juristë me autoritet dhe me zë që ka ky vend.

Ne si Kuvend kemi defektet tona dhe jam dakord me zotin Fino që thotë se jeni instrument i këtij Kuvendi; jam dakord me zotin Hyseni që thotë se ju jeni syri dhe mendja e komisionit dhe e Kuvendit, sepse për këtë ju ka ngarkuar ligji, por edhe ju duhet të bëni më shumë në këtë drejtim. Këtu e kam për zotin Spahiu, i cili është kryetari dhe për të gjithë anëtarët e këtij komisioni *ad-hoc*, sepse cilësia e monitorimit, e raporteve dhe rekomandimeve që keni bërë është me të vërtetë për t'u lavdëruar. Këtë nuk e them se ma kërkon funksioni që kam, sepse regjistrohen që të gjitha, por sepse e meritoni.

Dua të përmend disa shqetësime të përbashkëta që kemi pasur lidhur me Këshillin e Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi. Të jemi të qartë me kolegët, ky institucion kushtetues do të bëjë listimin e anëtarëve për Gjykatën Kushtetuese, për Presidentin e Republikës, për Kuvendin e Shqipërisë, por edhe kandidaturat që vijnë nga Gjykata e Lartë dhe do të bëjë përzgjedhjen e kandidaturës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që do t'i vijë Kuvendit për votim. Ky nuk është organ që bën thjesht përzgjedhje dhe vlerësim, por është organ shumë i rëndësishëm, sepse është parë edhe si mekanizëm zhbllokimi në Kushtetutë, pra nëse Kuvendi nuk e zgjidh anëtarin e Gjykatës Kushtetuese me 84 vota, automatikisht votohet emri i atij që i është zyrtarizuar emri i pari në Fletoren Zyrtare, pra është një organ shumë i rëndësishëm.

Cili është debati që kemi me KPED-në? Është e vërtetë që ka një raport i prodhuar nga komisioni që drejton zoti Spahiu, i cili i është përcjellë Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi. Jam në dijeni të këtij shqetësimi dhe kam biseduar pa e ngritur në

nivelin e një shqetësimi për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, sepse edhe ato kanë shqetësimin institucional dhe këmbëngulin fort në pavarësinë e institucionit.

Ka një pretendim, i cilit thotë: “Ne i rrimë strikt nenit 233 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sepse pika 1 thotë: “Mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë me dyer të mbyllura”.

Pika 2 thotë: “Përfaqësuesit e autorizuar të Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Kuvendit dhe dy anëtarë të Komisionit të përhershëm të Ligjeve, marrin pjesë me të gjitha të drejtat në mbledhjet e këtij Këshilli, por nuk kanë të drejtë vote”, ata thonë se ne e kemi ezauruar transparencën tonë në drejtim të Kuvendit, sepse janë tri institucione. Pra Kryetarin e Kuvendit E ka përfaqësues të autorizuar, Komisioni i Ligjeve ka dy përfaqësues, një nga maxhoranca dhe një nga opozita, dhe Presidenti i Republikës ka një përfaqësues. Neni 233 thotë: “vendos detyrimin ligjor që mbledhjet janë të mbyllura. Komunikon me publikun me një deklaratë për media, por dhe duke bërë publike në mënyrë të përmbledhur procesverbalet e mbledhjes”.

Unë e kam ngritur këtë shqetësim, sepse kam qenë dy herë në mbledhje të atij këshilli dhe ju kam thënë: “Po në rast se Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi autorizon komisionin e pavarur *ad hoc* për monitorimin? Komisioni thotë: “Absolutisht që jemi dakord. Autorizoni ju si Kuvend dhe si komision që tagrat e përfaqësimit tuaj ia jepni komisionit *ad hoc* dhe kjo çështje zgjidhet”. Unë u kam thënë se nuk është çështja që ta autorizojmë, por këtë duhet ta thoni në Rregullore, sepse në rregulloren që është miratuar ata e kanë përjashtuar atë komision. Për këtë ne jemi në diskutim e sipër që ajo pikë e Rregullores të amendohet dhe të na lihet hapësirë ne si komision dhe si Kuvend që të autorizojmë strukturat *ad hoc* që kemi ngritur me votën tonë. Unë nuk kam qenë dakord që në ato mbledhje këta si komision të mos jenë prezent, por kam kërkuar me forcë që të jenë. Por tani me rekomandimet që do të bëjë Kuvendi i Shqipërisë duhet ta themi me forcë që këtij komisioni nuk ka përse t’i mohohet e drejta për të qenë prezent në mbledhjet e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi.

Zoti Spahiu, një problematikë tjetër është moskthimi i përgjigjes që nuk merrni nga disa institucione. Ju thatë se keni komunikim dhe bashkëpunim të shkëlqyer me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, por kjo nuk duhet të ngelet në faktin se ju ftojnë në mbledhje dhe ju i dërgoni raportet, po përgjigjet që ju kërkon a i merrni? Nuk i keni marrë. Edhe kjo duhet jetë pjesë e raportit tuaj që ne do t’ia vëmë në dispozicion Kryetarit të Kuvendit, sepse ne ndërhyjmë nëpërmjet Kuvendit. Nëse dikush në këto organe, që janë ngritur rishtaz dhe sipas Kushtetutës dhe ligjit e kanë detyrimin të raportojnë dhe të kthejnë

përgjigje, nuk e bën si duhet detyrën, unë jam dakord me zotin Fino, ka instrumente Kuvendi, sepse jemi republikë parlamentare. Pra, edhe kjo është shqetësuese.

E fundit fare, aktualisht në Këshillin e Legjislacionit kemi në diskutim disa ndryshime të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese, në një vendim të sajën, ka rekomanduar për t'u bërë në ligjin "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", por edhe në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve". Unë nuk jam pjesë përbërëse e Këshillit të Legjislacionit, por sipas Rregullores ai draft paraparak, që do të miratohet në Këshillin e Legjislacionit dhe do të reflektojë në këto dy ligje atë çfarë ka urdhëruar Gjykata Kushtetuese, do të vijë në Komisionin e Ligjeve si komision përgjegjës. Unë kam kërkuar mirëkuptimin e kolegëve atje dhe u kam transmetuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, por edhe juve si strukturë që ne për çështje që kanë të bëjnë me saktësime ligjore në këto dy ligje dhe me qartësime ligjore të mos ngushtohemi vetëm në reflektimin e këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Pra, nëse ju si komision keni thënë se sipas nenit 115 të ligjit "Për organet e qeverisjes" duhet të qartësohet procedura e votimit, këtë them edhe unë: po, neni 115 atë ka pasur në konsideratë, të mos jetë bllokues.

Kur kemi pranuar votimin edhe me një kandidat në garë, kemi pasur në konsideratë që të mos ndodhemi në një situatë bllokuese për shkak të mos pasjes së kandidaturave të tjera.

Ju sugjeroni që të paktën të ketë kuorum për votat pro të kandidatëve. Kjo është çështje ligjore, prandaj sugjerojeni. Ne jemi në punë e sipër. Por edhe nëse në konsultimet që do të kemi me EURALIUS-in dhe me OPDAT-in, me të cilët e kemi bërë këtë ligj, por edhe me përfaqësuesit e KLGJ-së, KLP-së dhe të organet e tjera, do të shikohet kjo gjë, le ta bëjmë, pse jo.

Në këtë kuptim raportet dhe rekomandimet që ju bëni janë shumë të vlefshme për ne në radhë të parë. Këtu kanë raportuar një pjesë e drejtuesve të institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj, por do të vijë të raportojë edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, gjithashtu kemi kërkuar të vijnë raporte periodike edhe nga organet e vetë, për të parë ecurinë e procesit në kuadër të monitorimit të zbatimit të reformës në drejtësi. Por ne mjaftohemi me raportimet që bëhen këtu, ndërsa ju vini në lëvizje Komisionin e Ligjeve dhe ne Kuvendin e Shqipërisë sa herë që e kërkojmë ne, por edhe sa herë që e kërkon ju. Ju mbledheni, prodhoni raportet, bëni monitorimet dhe të gjitha, por, nëse keni nevojë, sepse komisioni përgjegjës ka edhe detyra të tjera të ngarkuara nga rregullorja, ju mund të na kërkon seancë dëgjimore të posaçme për një problematikë të caktuar dhe ne jemi dakord.

Për ta mbyllur, me autoritetin e kësaj strukture, ju në njërin krah dhe ne, me aq sa na takon si komision dhe si Kuvend në krahun tjetër, do të duhet të ulemi ta diskutojmë këtë pikë.

Ka një mendim për këtë komision, që të jemi të qartë, që u krijua një komision *ad-hoc* thjesht në përmbushje të nenit 288 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, por nuk e njeh askush dhe nuk ka personalitete të spikatura.

Më lejoni ta them troç dhe saktë, më vjen mirë që edhe kolegët u bashkuan me mendimin që kam unë, ky komision i ka të gjitha kapacitetet e duhura juridike dhe ligjore për ta kryer si duhet detyrën, këtë e them me bindje. I kam lexuar me vëmendje të gjitha raportet që prodhohen dhe më vjen mirë që është në nivel juristësh, se nuk është e thënë që je personalitet dhe figurë e njohur publike dhe di ta bësh punën mirë, ndërsa kur nuk je nuk di ta bësh punën mirë. Po ju them se në variantin e parë ky komision ka qenë konceptuar si një këshill i të urtëve dhe unë personalisht e kam kundërshtuar, dhe kam thënë se ky është mekanizëm i Kuvendit të Shqipërisë dhe duhet të jetë strikt dhe i saktë siç e ka ligji, jurist.

Ju keni përgëzimet e të gjithë komisionit, por autoritetin do ta vendosni ju dhe ne bashkërisht.

Falënderoj zotin Spahiu dhe të gjithë kolegë të tjerë, si zotin Vishaj, zonjën Nino, zonjën Rusmali, por edhe zotin Plloçi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Braho, më fal, ta mbyll fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Pra, dua të falënderoj edhe zotin Plloçi, i cili për arsye objektive familjare nuk ishte prezent, por edhe të gjithë kolegët e mi deputetë që erdhën në këtë seancë shumë të rëndësishme dëgjimore.

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Zoti kryetar, ne evidentuam një sërë problemesh lidhur me raportimin e zotërinjve, por çështja është çfarë zgjidhëm. Rregullorja e parlamentit na detyron që gjërat t’i zgjidhim këtu në diskutim. Do të bëjmë amendament, propozim për amendament, do të bëjmë rekomandim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Braho, disa nga shqetësimet që ngriti zoti Spahiu jemi në rrugë e sipër për t'i zgjidhur dhe të gjitha ndryshimet ligjore ne do t'i adresojmë. Ndërsa për qëndrimet që do të mbajmë ne si Kuvend për këtë mungesë komunikimi me organet e sistemit të qeverisjes së drejtësisë, patjetër që do ta adresojmë nëpërmjet Kryetarit të Kuvendit, të cilit do t'i bëjmë një raport të hollësishëm në lidhje me këtë seancë dëgjimore që bëmë sot.

Edhe një herë shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA